

Zhvillimi i disa fushave në të mësuarit me kompetenca

Çështjet:

Zhvillimi i disa fushave në të mësuarit me kompetenca

Udhëzime metodologjike

Llojet e vlerësimit s

Të dëgjuarit

Nxënësit tregojnë sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, kontakt me sy, pëlqim, nxitje dhe interes. Ata dëgjojnë dhe kuptojnë një larmi tekstesh, si dhe shprehin opinionet dhe vlerësimin e tyre rreth këtyre teksteve.

Të folurit

Nxënësit shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; përdorin gjatë të folurit edhe elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

Të lexuarit

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve.

Të shkruarit

Nxënësit shkruajnë për qëllime dhe dëgjues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, atëherë ata duhet të zotërojnë njohuri, të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kështu, nxënësit njohin

pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; njohin llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; kanënjohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre. Gjithashtu, nxënësit ndërgjegjësohen për pasurinë dhe vlerat shprehëse që ka gjuha.

Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve. Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënës, pyetja sjell pyetjen etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënës dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënës. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” në nivelin parë ka për synim matjen e kompetencave të fushës të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënës. Mësimdhënia duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

a) Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lëndët e fushës “Gjuhëtdhe komunikimi” kërkojnë që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehitë dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënës dhe nevojat e nxënësve.

b) Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës shqipe dhe gjuhës së huaj shpesh do të nxitin të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Udhëzime për vlerësimin

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit ,të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në procesin e të nxënit dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien. Vlerësimi i nxënësve për fushën “Gjuhët dhe komunikimi” ka për synim matjen e kompetencave të fushës të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënit.

Llojet e vlerësimit

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë, që kanë nxënësit rreth asaj, për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënit e nxënësve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi i vazhdueshëm është një proces, që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

Vlerësimi përmbledhës kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të

nxënit. Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti. Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për prezantimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara individualisht ose në grup.

Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet.